

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË DRAGASH, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje nga gjyqtari Sabaheta Kurteshi me sekretaren juridike Senida Nuri – punëtore e kësaj gjykate, në çështjen juridike të paditësve S. K., nga fshati..., Komuna e Dragashit **të cilën e përfaqëson me autorizim av. B. B. nga Prizreni, kunder të paditurit H. M. etj nga fsh..., Komuna e Dragashit**, për shkak të hyrjes në posedim dhe ndalimit të servitut kalimit, ma mas të përkohshme , me dt. **11.03.2019**, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET padia S. K., nga fshati..., Komuna e Dragashit, **të cilën e përfaqëson me autorizim av. B. B. nga Prizreni, kunder të paditurit H. M., etj nga fsh..., Komuna e Dragashit**, për shkak të hyrjes në posedim dhe ndalimit të servitut kalimit, me mas të përkohshme e si e **TËRHEQUR**.

A r s y e t i m

Pranë gjykatës Themelore në Prizren dega në Dragash është iniciuar procedura civile sipas padisë së S. K., nga fshati..., Komuna e Dragashit **të cilën e përfaqëson me autorizim av. B. B. nga Prizreni, kunder të paditurit H. M. nga fsh..., Komuna e Dragashit**, për shkak të hyrjes në posedim dhe ndalimit të servitut kalimit, me mas të përkohshme.

Gjykata Themelore në Prizren dega në Dragash, me datën 11.03.2019 ka caktuar seancën përgatitore ku ka konstatuar se nga palët nuk është paraqitur i autorizuari i paditësit av. B. B. Nga Prizreni, a ka fakte se ka qen i thirrur në menyr të rregullt nga se shifet nga shkresat lendes, ku fledërgesa është nënshkruar dhe pranuar nga ana e tij.

Në seancën përgatitore nuk ka qen prezent i padituri pasi qe për të njëjtin gjykata nuk ka fakte se është i thirrur në mënyrë të rregullt.

Andaj pasi qe i autorizuari i paditëses nuk është paraqit në seancën edhe pse ka qen i thirrur rregullisht konsiderohet se e ka tërhequr padinë.

Neni 409.1 i LPK-së, në menyrë decidive thotë *“në qoftëse paditësi nuk vjen në seancën prgatitore, edhe pse është thirrur në rregull, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit* “ e që në këtë rast i padituri nuk ka qen prezent andaj konsiderohet se paditësi ka tërhequr padinë.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - DEGA NË DRAGASH
C.nr. 102/18, më dt.11.03.2019.

Sekretare Juridike:
Senida Nuri

Gj y q t a r i :
Sabaheta Kurteshi

UDHËZIM JURIDIKË: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate.